REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI

DEÇANI

Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në përputhje me nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të Komunës, dhe nenet 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Kapitullit III të Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, me propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.05.2017, bie këtë:

V E N D I M

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS KOMUNALE ME KONKURS PUBLIK

I.

Merret Vendimi për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vite me konkurs publik të tokës në pronësinë komunale, me qëllim të përfitimit publik, që përfshinë ngastrën kadastrale nr. **01098-0** në sipërfaqe prej 107210 m^2 mal i klasës 3, vendi i quajtur Bllata, Zona Kadastrale Drenoc.

II.

Në ngastrën e cekur më lartë me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, parashihet që të ndërtohen dhe ngriten kapacitete që kanë të bëjnë vetëm me riciklim të mbeturinave, me qëllim të përfitimit publik.

III.

Me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të ngastrës të cekur më lartë, marrësi i tokës në shfrytëzim duhet t'u përmbahet Rregulloreve dhe Ligjeve në fuqi .

IV.

Për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite autorizohet Komisioni Komunal i formuar në Asamble, sipas të gjitha Ligjeve në fuqi.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

VI.

Me nga një kopje të Vendimit do të paisen:Komisioni Komunal i formuar në Asamble dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.V-6
Deçan,dt.26.05.2017

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj

HYRESE ULAZNA-INGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPŠTINA DEČANE - DEÇANI MUNICIPALITY
Nga: Od: From: K.K. Deçan AS
Nr. Prot: Br. Prot: Prot. No. 15673
Nr. i faqeve: Br. Stranica: No. Pages: 01
Data: Datum: Date: 02.6.17
DEÇAN DEČANE